



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/OPK  
 Nr. Prot. 01-3524/14  
 Br. Prot. 03  
 Prot. No. 09-10-2014  
 Nr. i faq. 03  
 Data 09-10-2014  
 Broj stranica  
 Nr. pages  
 PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	08.10.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdurrahman URUÇI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Ferizajt
CC:	z. Muharrem SVARQA Kryetar i Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Lot 1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj"

*I nderuari z. Uruçi ,*

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Lot 1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj" me numër prokurimi: 656-14-290-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Në lidhje me monitorimin e tenderit me titull " Lot 1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj" me numër prokurimi: 656-14-290-121 i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajt.



## *A r s y e t i m i*

Komuna e Ferizajt si Autoriteti kontraktues me dt.16.07.2014, ka bërë publikimin e Njoftimit për Kontratë në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP). Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur dhe ka bërë ndarjen e këtij aktiviteti të prokurimit në dy lote ( pjesë) në lot 1 ka paraparë furnizimin me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së, ndërsa për lot 2 ka paraparë Furnizimin me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së Ferizaj.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.05.08.2014 ka paraqitur kërkesë zyrtare për dokumentacion pranë autoritetit kontraktues lidhur me këtë procedurë të prokurimit, ku me ç 'rast është njoftuar nga ana e autoritetit kontraktues se lënda është duke u trajtuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Më dt.25.08.2014 Autoriteti kontraktues ka pranuar njoftimin zyrtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit me të cilin është obliguar të bëjë zgjatjen e afateve të tenderimit.

Me dt.25.08.2014 përmes faqes elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) autoriteti kontraktues ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë ( zgjatje e afatit të tenderimit) deri me dt.04.09.2014. Agjencia kundër Korrupsionit me dt.08.09.2014 i 'u është drejtuar Autoritetit kontraktues me shkresën me nr. protokollit Z-D/DPK-01-2792/14 ku ka kërkuar nga Institucioni që dokumentacionin e kërkuar ta ofroj në Agjenci para se Autoriteti kontraktues ta bëjë Njoftimin për dhënie të kontratës.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka marr pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e tenderëve dhe ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet e tenderit me titull "*Lot 1 Furnizimi me 1 aparat të mamografisë për diagnostifikimin e kancerit të gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 Sterilizator për nevojat e QKMF-së Ferizaj dhe Lot 2 Furnizimi me 5 karrige Stomatologjike për nevoja të QKMF-së QKMF- së Ferizaj*" ka konstatuar të dhënat si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 37 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 13 OE.

Komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar dhe vlerësuar ofertat për lot 1 ka konstatuar se për këtë lot kanë ofertuar 10 Operatorë ekonomik ku 4 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa 6 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Për lot 2 ofertat e tyre i kanë dorëzuar 7 Operator ekonomik, ndërsa pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave Komisioni vlerësues ka ardhur në përfundim se 6 OE janë të përgjegjshëm.

Komisioni për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave të të Operatorëve Ekonomik që kanë ofruar tender të përgjegjshëm, konstatoi dhe erdhi në përfundim se për lot 1 Operatori ekonomik i renditur në numrin 1 në raportin e vlerësimit të tenderëve nga Operatorët e përgjegjshëm i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe ka ofruar çmimin më të ulët, andaj Komisioni vlerësues ka rekomanduar lidhjen e kontratës me këtë Operator ekonomik. Për lot 2 Komisioni vlerësues ka konstatuar se Operatori i renditur në nr. 1 i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit si dhe ka ofruar





çmimin më të ulët, andaj Komisioni vlerësues ka rekomanduar që për këtë lot të lidhet kontrata më këtë Operator ekonomik.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderi ka vërejtur se në dosjen e tenderit Autoriteti kontraktues tek rubrika *III.2.4) kapaciteti teknik dhe profesional* tek pjesa dëshmia e kërkuar dokumentare për mamografi: ka kërkuar Autorizimin nga prodhuesi, Deklaratën e konfirmimitit, Certifikatën ISO 9001,9002 , FDA dhe certifikata CE, vërtetimin nga prodhuesi, garancionin gjithëpërfshirës së paku 12 muaj dhe lista e pjesëve të rëndësishme rezervë me kodin e prodhuesit. Këto kërkesa janë caktuar vetëm për aparatën e mamografisë, ndërsa Komisioni vlerësues për shkak të paqartësive që ka pasur rreth kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit, kërkesat e njëjta i ka përdorur për të dy lotet ( për të gjitha pajisjet). Pas konsultimeve që janë bërë në mes anëtarëve të Komisionit vlerësues, Zyrtarit kryesor të Prokurimit dhe përfaqësuesve të Agjencisë kundër Korrupsionit, Komisioni vlerësues kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit tek rubrika Kapaciteti teknik ose profesional i ka aplikuar vetëm për aparatën e mamografisë duke respektuar në përpikëri rekomandimet e Agjencisë duke aplikuar kërkesat e lartë cekura vetëm për aparatën e mamografisë, ashtu siç është kërkuar edhe në dosjen e tenderit.

Andaj duk u bazuar në dhënat të cekura si më lartë Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se procedura e vlerësimit të tenderëve është zhvilluar sipas Ligjit në fuqi për Prokurimit Publik, andaj nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

***Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.***

Me respekt !